



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:195652
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05698665

AA.nr.689/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Sh.H, Komuna e Podujevës, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve me selin në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimeve dhe njohjes së të drejtës në pension kontribut pagues të moshës, përkritazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2019/2021, të datës;03.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje administrative, A.nr.2019/2021, të datës;03.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2019/2021, të datës;03.07.2023, është vendosur, *“I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit, Sh.H, Komuna e Podujevës, për njohjen e pensionit kontribut pagues të moshës në kategorinë e dytë me përgatitje të mesme shkollare, që nga data e aplikimit datë 30.03.2021, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për pension të tillë, si e bazuar. II. Anullohet Vendimi i shkallës së parë nr. i dosjes 356400, i datës 30.04.2021 dhe Vendimi i shkallës së dytë nr. i dosjes 356400, i datës 31.05.2021 të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve në Prishtinë. III. Detyrohet e paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve, që paditësit, Sh.H në mënyrë retroaktive, t’ia paguaj diferencën në mes shumës së pensionit bazë prej 90 Euro (nëntëdhjetë euro) dhe pensionit kontribut- pagues prej 198 Euro (njëqind e nëntëdhjetë e tetë euro) nga data e aplikimit- datë 30.03.2021, deri me nxjerrjen e këtij vendimi datë 03.07.2023, dhe pas kësaj periudhe të ja njeh të drejtën e këtij pensioni në shumë 198 Euro (njëqind e nëntëdhjetë e tetë euro) deri sa të*

ekzistojnë kushte ligjore, të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit me detyrim.”

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2019/2021, të datës;03.07.2023, të ndryshoj dhe të vendosë në mënyrë meritore.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të paditurës dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;31.08.2021, kundër vendimeve të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, sepse konsideron se vendimet e kundërshtuara me padi janë të pa bazuar dhe jo i ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që të anulohen në tërësi, si dhe t'i njihet e drejta në pension kontributpagues të moshës.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimet e kundërshtuara dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, me arsyetim se “Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 dhe 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative ashtu që vendosi që vetë meritorisht ta vendosë këtë çështje administrative. Gjykata duke vlerësuar e vendimin e goditur me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve të padisë, përgjegjes së dhënë nga e paditura ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar. Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla, për shkak të te cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47.2 përcaktohet se struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, ku një ndër këto elemente është se “Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, akti administrativ i shkruar përmban emrin dhe mbiemrin e shkruar dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës gjegjësisht kryetarit dhe të procesmbajtësit të organit kolegjal. Nëse procesmbajtësi ndodhet në pamundësi për të nënshkruar, në vend të tij nënshkruar një nga anëtarët e organit kolegjal”. Ndërsa në nenin 48 të këtij ligji është përcaktuar se “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë

arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë është vërtetuar se nuk janë plotësuar kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues konform nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ngase nuk janë prezantuar dëshmi të mjaftueshme në kuptim të ligjit të cekur më lartë për 15 vite stazh kontributiv, gjegjësisht janë prezantuar prova materiale me të dhëna për (14 vite e 6 muaj 2 ditë)”. Gjykata vëren se e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues vetëm ka bërë citimin e nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, duke mos vlerësuar asnjë nga pretendimet e paditëses me ankesë, se pse paditësi nuk i ka plotësuar kërkesat ligjore për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues të moshës. Për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, gjykata i’u referua Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenit 8 të të njëjtit, ku përcaktohet se “Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1.kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;1.2.duhet të ketë stazh pensional kontribut dhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës;01.01.1999;1.3.ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës;01.01.1999. 2.Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontribut dhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjerë, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratoj ministria përkatëse. 3.Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontribut pagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuara me këtë ligj. 4.Përrjashtimisht, shfrytëzuesit e pensionit kontribut pagues të moshës, dhe shfrytëzuesit e pensioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj, mund të jenë edhe shtetasit e huaj, me shtetin e të cilëve, Republika e Kosovës, lidh Marrëveshje Bilaterale për sigurimet sociale. 5.Dispozitat e Marrëveshjeve Bilaterale të sigurimeve sociale, të cilat i lidh Republika e Kosovës me shtetet përkatëse, kanë epërsi ndaj dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera nga fusha e sigurimeve sociale. 6.Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”. Po ashtu Gjykata iu referua edhe Udhëzimit Administrativ nr.09/2015, për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, nenit 6 të të njëjtit, i cili përcakton se “6.1.Te gjithë shfrytëzuesit e pensionit kontribut pagues, përkatësisht të siguruarit me rastin e parashtrimit të kërkesës për pension kontributpagues, bazuar në kategorizimin sipas strukturës kualifikuese, duhet të sjellin dëshmitë relevante të përcaktuara në nenin 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi, varësisht se për cilën kategori aplikojnë. 2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në dispozitat e Ligjit në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, shfrytëzuesit aktual dhe ata që aplikojnë në të ardhmen, duhet të paraqesin dokumentet e nevojshme, si: 2.1. Letërnjoftimin e republikës së Kosovës 2.2. Ekstraktin e Lindjes 2.3. të kenë stazh pensional kontribut dhënës se paku pesëmbëdhjetë (15) vjet para datës 01.01.1999 , sipas ligjit SPI-se Nr.26/83 , i cili vërteton me ndonjë nga këto dokumente si :2.3.1. vendimin se ka qenë shfrytëzues i pensionit kontribut pagues sipas dispozitave të ligjit SPI-së Nr.26/83 para datës 01.01.1999;2.3.2 çekun për pagesën e pensionit kontributiv sipas dispozitave nga Ligji i SPI-së të Kosovës;2.3.3 librezën e punës me numërim amëz të të siguruarit;2.3.4 dëshmitë se i ka paguar kontributet vet ose punëdhënësi ku ka punuar;2.3.5. ekstraktin nga M-4, nëse i posedojnë zyrat pensionale, te cilat nxirren, verifikohen dhe plotësohen nga zyrtari për verifikim i stazhit pensional në formularin përkatës ;2.3.6. dëshmi se nuk është përfitues i pensionit nga ndonjë prej shteteve për te cilat Kosova nuk ka marrëveshje;2.3.7 dëshmi për njohjen e stazhit te punës për te pensionuarit e arsimit, të shëndetësisë dhe te tjerëve qe kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës nga viti 1989-

1999 e verifikuar nga qeveria përkatësisht ministritë relative ;2.4 Të ofroj dëshmi se ne Bazën e të Dhënave të ish Teknologjisë Informativë, e ashtuquajtura Qendra Elektronike Llogaritare e ish BVI-SPI-se të Kosovës Regjionale, të cilat nxirren verifikohen dhe plotësohen nga zyrtari për verifikim i stazhit pensional në formularin përkatës në zyrat pensionale përkatëse.3. Ne rast se në Formularin M-4 mungon periudha kontributpaguese deri ne dymbëdhjetë (12) muaj përkatësisht një (1) vit dhe në të cilin konstatohet se i siguruari nuk ka bërë ndërrim të organizatës dhe ka mungesë të shënimeve për atë periudhë kontributiv në bazë të formularit M-4, të siguar mund ti njihet e drejta e periudhës kontribut paguese për atë vit. 4. Për rastet e tilla sipas paragrafit 3 të këtij neni , zyra penisonale detyrohet te përgatisë një proces të veçantë me te gjitha të dhënat e detajizuara. 5.Stazhi pensional i realizuar ne ish republikat e shtetit Jugosllavisë merret për bazë për njohën e së drejtës ne pensionin kontributiv, nëse i siguruari (aplikuesi), sjell dëshmi se nuk është shfrytëzues i pensionit kontributi ne republikat e dala nga ish shteti i Jugosllavisë , deri ne arritjen e marrëveshjeve bilaterale mbi sigurimin social në bazë të punës së kaluar. Për të vërtetuar faktin se paditësi i plotëson kërkesat nga ligji dhe udhëzimi i sipërcituar, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë; libreza e punës e datës 21.03.1978 me nr.regj.6355, kërkesa e datës .26.08.2021, vendimi datës 30.04.2021, kërkesa për pensionin kontributiv datës 03.03.2021, diploma e datës28.05.1976, pasqyra e të ardhurave personale e datës 28.04.21, vendimi i datës 12.04.2021, regjistrimi i aplikantit për pensionin bazë i datës 30.03.2021,si dhe diferencës në pension në mes të pensionit bazik që ka realizuar paditësi dhe ati kontribut pagues me përgatitje të mesme shkollore për periudhën dhe ata nga data e aplikimit 30.03.2021 dhe te gjitha se bashku duke iu referuar Nenit 6 paragrafi 3 i Udhëzimit të sipërcituar, i cili përcakton se “Ne rast se në Formularin M-4 mungon periudha kontributpaguese deri ne dymbëdhjetë (12) muaj përkatësisht një (1) vit dhe në të cilin konstatohet se i siguruari nuk ka bërë ndërrim të organizatës dhe ka mungesë të shënimeve për atë periudhë kontributive në bazë të formularit M-4, të siguar mund ti njihet e drejta e periudhës kontribut pagues për atë vit”, gjykata vërteton faktin se, paditësi ka 15 stazh kontributiv të nivelit të mesëm të përgatitjes shkollore sipas kërkesës se pensionit kontribut- pagues të datës 30.03.2021, e protokolluar me numër 06/293. Gjykata lidhur me kategorizimin sipas strukturës kualifikuese, ka gjetur se, në bazë të Diplomës së shkollës së mesme të datës 28.05.1976 me nr.611-58/74, vërteton se, paditësi ka përfunduar shkollën e mesme në vitin 1976, para vitit 1991 ne përputhje me UA 09/2015, përkatësisht bazuar në nenin 5, par 2, të UA 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzueseve të pensionit kontribut pagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve – stazhit pensione, ku shprehimisht është përcaktuar se :“Shfrytëzuesi i pensionit kotributpagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme, ndërsa paragrafi. 5 njëjtin nen parasheh se: Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991” ne interpretim te drejte te dispozitave te lartcekura dhe dëshmime për shkollim vërtetohet se paditësi i plotëson kriteret ligjore qe ti njihet pensioni baze kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme. Ndërsa, me nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ është paraparë që “Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”. Ndërsa neni 20 i Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat e Financuara nga Shteti Paguesa e pensioneve parasheh se, të gjitha pensionet që paguhen sipas këtij ligji, do të fillojnë të paguhen nga dita e parashtrimit të kërkesës, e që në vështrim te këtyre dispozitave e paditura me vendimin e atakuar i'a ka mohuar paditësit të drejtën për shfrytëzimin e pensionit të bazë kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme, e nga kjo rezulton se paditësit në momentin e ekzekutimit të vendimit të të paditurës i është shkaktuar dëm ngase nuk ka mundur të realizoj të ardhurat që kanë buruar nga e drejta në shfrytëzimin e pensionit kontribut pagues te moshës me shkollim mesme, andaj gjykata vendosi si në të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Në këtë kuptim gjykata

vlerëson se paditësi i ka plotësuar kërkesat e lartë cituara të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht kërkesat nga neni 8, si dhe Udhëzimit Administrativ nr.092015, për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributëve-Stazhit Pensional, dhe ia njuhë të drejtën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e anuluar vendimin e shkallës së parë nr. i dosjes 356400, i datës 30.04.2021 dhe vendimin i shkallës së dytë nr. të dosjes 356400, i datës 31.05.2021, të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve në Prishtinë dhe paditësit t'ia paguaj diferencën në mes shumës së pensionit bazë prej 90 euro dhe pensionit kontribut-pagues prej 198 euro nga data e aplikimit-datë 30.03.2021, deri me nxjerrjen e këtij vendimi datë 03.07.2023, dhe pas kësaj periudhe të ja njuh të drejtën e këtij pensioni në shumë 198 euro, deri sa të ekzistojnë kushte ligjore, të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit me detyrim. Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi mirëpo, të njëjtat i vlerëson si të pa bazuara, nga fakti se nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor është vërtetuar se paditësi i plotëson kërkesat e ligjit dhe udhëzimit të sipërcituar për njohjen e të drejtës së kërkuar dhe atë nga data e paraqitjes së kërkesës te e paditura.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, sipas vlerësimit të kolegjit ky pretendim ankimor nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave procedurale, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sipas vlerësimit të kolegjit edhe ky pretendim ankimor nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndron vërtetimit i gabuar i gjendjes faktike. Kolegji i apelit vëren gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi i plotëson kërkesat nga ligji dhe udhëzimi i sipërcituar, sipas Librezes së Punës, nr.127715, dhe me numër të regjistrimit 6355, drejtë është vërtetuar se paditësi kishte dëshmuar përvojën e punës prej 14 vite e 6 muaj e 2 ditë, fakt ky i konstatuar nga e paditura me vendimin e saj kontestues. Prandaj kolegji i apelit vlerëson se me nenin 6 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015, për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributëve-Stazhit Pensional është përcaktuar se, “Në rast se në Formularin M-4 mungon periudha kontributpaguese deri në dymbëdhjetë (12) muaj përkatësisht një (1) vit dhe në të cilin konstatohet se i siguruari nuk ka bërë ndërrim të organizatës dhe ka mungesë të shënimeve për atë periudhë kontributive në bazë të formularit M-4, të siguruarit mund ti njihet

e drejta e periudhës kontributpaguese për atë vit". Në këtë kuptim kolegji i apelit vlerëson se e paditura në kuptim të nenit 6 paragrafi 3 të Udhëzimit të sipërcituar është dashur që paditësit t'ia njohë edhe një vit të periudhës kontributpaguese, pasi që i njëjti është vërtetuar me të drejtë nga Gjykata e shkallës së parë se gjatë gjithë kohës ka punuar tek organizata e njëjtë, përkatësisht nuk e kishte ndërruar punëdhënësin.

Në këtë kuptim kolegji i apelit vlerëson se paditësi i ka plotësuar kërkesat e lart cituara të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht kërkesat nga neni 8, si dhe neni 6 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015, për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributëve-Stazhit Pensional, dhe me të drejtë Gjykata e shkallës së parë i ka njohur të drejtën në pension kontributpagues me përgatitje te mesme shkollore.

Kolegji i apelit verën se për këto raste siç është rasti i paditësit ekziston praktike gjyqësore e konfirmuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, kur palëve i është njohur kjo e drejtë, në rastet kur nuk e kanë arritur periudhën kohore prej 15 viteve, për një vit dhe atë në bazë të nenit 6 paragrafi 3 të Udhëzimit të lart cituar. (Shih aktgjykimin Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nën shenjën A.nr.2392/2018 të dt.27.01.2020, me paditëse, S.B nga Prishtina, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin nën shenjën AA.nr.201/2020 të dt.23.07.2021, aktgjykime këto të konfirmuara nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin nën shenjën ARJ-UZVP. Nr.108/2021 të dt.23.09.2021).

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i apelit të njëjtin pretendim nuk i aprovoj, për faktin se Gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar nenin 8 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, si dhe nenin 6 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015, për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributëve-Stazhit Pensional, nën ky në fuqi në kohën kur Gjykata e shkallës së parë e ka vendosur kërkesëpadinë e paditësit. Prandaj, të njëjtat pretendime janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit dhe se e njëjta drejtë ka zbatuar dispozitat Ligjit dhe Udhëzimit të sipërcituar.

Nga e gjithë kjo që u theksua më lartë dhe mbi këtë gjendje, faktike kolegji i apelit konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, dhe se thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga Gjykata e shkallës së parë, ngase aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, në këtë kuptim ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Numri i lëndës: 2021:195652
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05698665

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.689/2023, datë;13.05.2024

Kryetar i kolegjit
Hajriz Hoti